



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DECAN / OPŠTINA DEČANI

Drejtoria për Inspekcione
10 Nr. _____ 2019
Dt: 15.01.2019

MYTË DEKUPAZNA-INSPEKTORE	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPŠTINA DEČANE - DEČANI MUNICIPALITY	
Udhëzuesi: From:	Prot. No: 1392
Titulli: To:	02
Numri i fletës: No. Pages:	Date: 15.01.19
DEÇAN DEČANE	

Për : Kryetarin e komunës së Deçanit- z. Bashkim Ramosaj,

Nga: Drejtori i Drejtoratit për Inspekcione-Halil Tolaj

Lënda: *Plani i punës së Drejtoratit për Inspekcione për vitin 2019*

Datë: 15.01.2019

Plani vjetor i mbikëqyrjes inspektuese përmban një pasqyrë të përgjithshme të detyrave dhe punëve të Drejtoratit për inspekcione për vitin 2019 për aplikimin e drejtpërdrejtë të ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve komunale për përcjelljen e gjendjes në teritorin e komunës së Deçanit.

Qëllimi i hartimit të planit vjetor të punës së Drejtoratit për inspekcione është rritja e efikasitetit dhe transparencës dhe forcimi i besimit të qytetarëve të komunës së Deçanit në Qeverisjen Lokale të komunës së Deçanit përmes :

- zbatimit të drejtpërdrejt të ligjeve dhe akteve tjera,
- mbikëqyrjes inspektuese dhe zgjedhjes së çështjeve administrative si organ i shkallës së parë,
- përcjelljes së gjendjes dhe propozimit të masave për përmirësimin e gjendjes në teren në teritorin e komunës në të gjitha lëmit nga fushë veprimtaria e drejtoratit,
- veprimet preventiv të inspektionit si masë për realizimin e qëllimit të mbikëqyrjes inspektuese.

Caqet e planit vjetor të mbikëqyrjes inspektuese janë aplikimi i drejtpërdrejtë i ligjeve dhe akteve tjera nënligjore lidhur me masat e planifikuara dhe aktivitetet e veprimet preventiv të inspektionit për veprimet

jashtëligjore nga të gjitha lëmit duke mos përjashtuar edhe ndëshkimet ligjore për shkelësit e mundshëm të ligjeve dhe akteve nënligjore. Punët dhe detyrat nga fushë veprimtaria, gjegjësisht nga plani vjetor i punës, inspektorët do të kryejnë çdo ditë pune qofte në vendin e punës apo në teren, e sipas nevojë edhe ditëve të vikendit dhe ditëve të festave. Drejtorati për inspekcione veprimtarin e vet gjatë vitit 2019 do ta orientoj në implementimin e Ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, akteve nënligjore dhe rregulloreve komunale, por edhe sipas kërkesave të Inspektorëve të Nivelit Qendror, Policisë së Kosovës, Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera kompetente.

Secili inspektor nga fushë veprimtaria përkatëse, do të kryej punë administrative dhe punë profesionale të mbikëqyrjes inspektuese, me qëllim të implementimit të Ligjeve përkatëse, akteve nënligjore dhe rregulloreve.

Punët dhe detyrat nga ky plan inspektorët secili nga lëmi përkatëse i kryejnë çdo ditë, në mënyrë të pavarur, çoftë në zyre apo drejtpërdrejt në teren. Inspektimet e rregullta sipas planit kryhen çdo ditë sipas planit të inspektorëve, kurse sipas nevojë dhe kërkesave të paraqitura kryhen edhe inspektime të jashtëzakonshme, e në raste të caktuara kryhen edhe inspektime plotësuese dhe kontrolluese me qëllim të përcjelljes së plotësisht të rekomandimeve paraprake të inspektorëve.

Inspektimet e pa planifikuara do të insistohet që të kryhen të njëjtën ditë të parashtrimit të kërkesës së qytetarit, subjektit apo të ndonjë organi tjetër me qëllim të parandalimit të dukurisë e cila bie ndesh me ligjet dhe aktet tjera normative nga lëmi përkatëse.

Inspektorët përparësi do të ju japin vizitave këshillëdhënëse, ku subjektet e mbikëqyrura do të njoftohen me dispozitat ligjore përkatëse, plotësimet dhe ndryshimet eventuale të tyre dhe do të ju japin këshilla profesionale si masë parandaluese, duke mos përjashtuar leshurjen e aktvendimeve për ndalimin e aktiviteteve jashtë ligjore apo edhe ndërmarrjen e veprimeve ndëshkimore në harmoni me Ligjet përkatëse.

Moto e punës së inspektorëve do të jetë kontrolli së paku njëherë i të gjitha subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes inspektuese sipas ligjeve dhe akteve në fuqi, por edhe shmangja në maksimum i kontrolleve të përsëritura pa nevojë.

Aktualisht në kuadër të Drejtoratit funksionojnë këta inspektorë:

- shefi i inspekcionit si koordinator i punës së inspektorëve.
- Inspektori i tregut,

- Inspektori Sanitar,
- Inspektori i mbrojtjes së ambientit.
- Inspektori i Ndërtimit (i angazhuar me kontrate si punë sekondare)

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat për secilin inspektor janë të përcaktuara me Ligjin përkatëse sipas fushë veprimtarisë që e mbulojnë por edhe me ligjet tjera që rregullojnë fusha të caktuara secilit i janë përcaktuar kompetencat.

Inspektorët do të kryejnë detyrat që janë në kompetencë të inspektorëve komunal në mbështetje të ligjeve përkatëse për inspektorët sipas fushë veprimtarive dhe akteve tjera nënligjore, përfshi edhe ato komunale, duke mos lënë anash bashkëpunimin e ngushtë me inspektorët e nivelit qendror në Ministrinë përkatëse.

Do të hartojnë planet periodike dhe vjetore për mbikëqyrjen inspektuese sipas detyrës zyrtare, por edhe në afatin më të shkurt të mundshëm do të ju përgjigjen kërkesave të qytetarëve dhe organeve qendrore dhe komunale. Për të njëjtat do të mbajnë evidencë zyrtare dhe do të raportojnë në organet përkatëse.

Gjate vitit 2019 Drejtorati për Inspekcione, gjegjësisht inspektorët e fushave përkatëse, kryesisht do të zhvilloj këto aktivitete:

Aktiviteti	Koha	Bartësi
Hartimi i planeve operative mujore për vitin 2019	Janar	Të gjithë Inspektorët
Koordinimi i aktiviteteve me ministrinë dhe inspektorët përkatës	Sipas kërkesave dhe nevojës	Të gjithë Inspektorët
Koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta të inspektorëve (tregut, sanitar ndërtimit, mjedisit, veterinar nëse angazhohet).	Çdo fillim jave.	Të gjithë inspektorët
Kontrollimi i produkteve për tregtim të artikujve ushqimor dhe jo-ushqimor, theksimi i çmimeve të mallrave të	Së paku njëherë në muaj dhe sipas ankesave dhe	Inspektori i Tregut

<p>dedikuara për treg.</p> <p>Mbikëqyrje parandalimi të ndotjes mjedisore nga substancat kontaminuese /rrezikshme me ndikim të rrezikshëm në tokë, ujë dhe ajër.</p> <p>Shqyrtim i kërkesave të parashtruara nga personat fizike dhe juridike.</p> <p>Hartimi i raporteve mujore të punës nga secili inspektor sipas fushë veprimtarisë përkatëse,</p> <p>Mbikëqyrja lidhur me përmbajtjen e orarit të punës së subjekteve afariste me mbikëqyrje të veçante të lokaleve hoteliere.</p> <p>Mbikëqyrja inspektuese lidhur me Vendimin e Qeveris për aplikimin e taksës 100% për mallrat e importuara nga Serbia dhe zbatimin i Urdhëresës për emërtimin Kushtetues të R. Së Kosovës në deklaracionet e mallrave të importuara nga Serbia qofshin ato edhe brenda ndërkombëtare.</p> <p>Inspektimi i ekspozimit të artikujve ushqimor jashtë lokaleve afariste,</p> <p>Mbikëqyrja inspektuese e shërbyesve me ushqim dhe pije nga aspekti sanitar të stabilimenteve dhe personelit,</p>	<p>kërkesave të konsumatorëve apo organeve tjera kompetente.</p> <p>Në vazhdimësi dhe sipas kërkesave.</p> <p>Në vazhdimësi sipas kërkesave të arritura.</p> <p>Në fillim të çdo muaji për muajin paraprak.</p> <p>Së paku njëherë në muaj dhe sipas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve apo organeve kompetente</p> <p>Në vazhdimësi</p> <p>Në vazhdimësi</p>	<p>Inspektorja e Ambientit</p> <p>Secili inspektor sipas fushë veprimtarisë.</p> <p>Secili Inspektor</p> <p>Inspektori i Tregut (në bashkëpunim me inspektorët tjerë dhe Policin e Kosovës)</p> <p>Inspektori i Tregut (në bashkëpunim me inspektorët tjerë)</p> <p>Inspektori Sanitarë</p>
---	---	---

<p>Kontrollimi i kualitetit të ujit për pije në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe propozimi i masave,</p>	<p>Njëherë në muaj dhe sipas kërkesave dhe ankesave.</p>	<p>Inspektori Sanitarë</p>
<p>Dhënia e pëlqimit me rastin e dhënies se lejes ndërtimore për objektet të parapara me ligjin mbi Inspektionin Sanitar Kontrollimi i të gjitha subjekteve afariste lidhur me afatin e skadences së artikujve për tregtim.</p>	<p>Njëherë në muaj dhe sipas kërkesës Së pakut një here në muaj dhe sipas nevojë dhe kërkesave.</p>	<p>Inspektori Sanitarë Inspektori Sanitarë në bashkëpunime inspektorë tjerë.</p>
<p>Inspektim/kontrollim i lokaleve afariste për ndalim të pirjes së duhanit.</p>	<p>Në vazhdimësi dhe sipas kërkesave</p>	
<p>Inspektime në shkolla me qëllim kontrollimin dhe vlerësimin e kushteve të përgjithshme higjienikë dhe sanitare, vlerësimin e tyre dhe marrjen e masave për eliminimin e faktorëve që mundë të sjellin pasoj drektë në shëndetin e nxënësve dhe personelit mësimor.</p>	<p>Në vazhdimësi dhe sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo tjerëve.</p>	<p>Inspektori Sanitarë</p>
<p>Kontrolle inspektuese në çerdhe të qytetit me qëllim të ngritjes së higjienës së përgjithshme, mënyrën e ushqimit të fëmijëve dhe kushteve të ruajtjes së ushqimit për ta, si dhe verifikimin e kontrollit shëndetësor të stafit,</p>	<p>Së paku njëherë në tre muaj dhe sipas nevojës.</p>	<p>Inspektori Sanitarë</p>
<p>Zbatim i Rregullores Komunale mbi plotësimin e kushteve minimale teknike dhe sanitare nga aspekti i hapësirave punuese si dhe pajisjeve dhe stabilimenteve për punë.</p>	<p>Në vazhdimësi varësisht nga kërkesat</p>	<p>Inspektori i tregut, Sanitarë dhe i ambientit.</p>
<p>Inspektim dhe rregullim i tregut të</p>	<p>Njëherë në javë</p>	<p>Inspektori i tregut</p>

gjelbër.	ditën e tregut	Sanitar dhe veterinar (nëse angazhohet)
Inspektimi i objekteve ndërtimore pas njoftimit të organit kompetent për dhënien e lejes ndërtimore lidhur me zbatimin e lejes (në fillim dhe përfundim të punimeve)	Sipas nevojës	Inspektori i Ndërtimit
Inspektimi në teren për ndërtimet pa leje dhe ndërmarrja e masave parandaluese,	E vazhdueshme	Inspektori i Ndërtimit
Mbikëqyrje aktiviteteve më ndikim negativë në mjedis si dhe mundësitë e parandalimit të tyre.	E vazhdueshme	Inspektorja e Ambientit
Ndalimi i eksploatimit të rërës dhe zhavorrit dhe degradimi i lumenjve.	E vazhdueshme	Inspektori i Ambientit
Kontrolle/mbikëqyrje pjesës urbane dhe rurale për mbrojtje të mjedisit nga hedhja e mbeturinave amvisërisë dhe mbeturinave inerte.	E vazhdueshme	Inspektorja e Ambientit
Mbikëqyrja inspektuese e subjekteve ekonomike që me veprimtarin e tyre gjenerojn mbeturina inerte të pa rrezikshme.	E vazhdueshme	Inspektorja e Ambientit
Mbikëqyrja inspektuese e operatorëve që posedojnë leje për operim me mbeturina të pa rrezikshme dhe e operatorëve që veprimtarin e kryejnë pa leje përkatëse. Mbikëqyrja e inspektuese e ndotësve të ujit, ajrit etj.	E vazhdueshme	Inspektorja e Ambientit
Identifikimi i deponive ilegale, përpilimi i raportit për gjendjen dhe vende	Mars	Inspektorja e Ambientit

ndodhjen e tyre dhe propozimi i masave për eliminimin e tyre		dhe sanitar
Kontroll inspektuese e thertoreve të kafshëve,	E vazhdueshme.	Inspektori veterinarë (nëse angazhohet)
Kontroll inspektuese e objekteve ku bëhet përpunimi i mishit të kafshëve dhe shpezëve,	E vazhdueshme	Inspektori veterinarë (nëse angazhohet)
Kontroll inspektuese e farmacive veterinerë,	E vazhdueshme	Inspektori veterinarë (nëse angazhohet)
Kontroll inspektuese e marketeve dhe dyqaneve ku tregtohet mishi i kafshëve dhe shpezëve,	E vazhdueshme	Inspektori veterinarë (nëse angazhohet)
Kontroll inspektuese e dyqaneve dhe depove ku tregtohet dhe deponohet ushqimi i kafshëve dhe shpezëve,	E vazhdueshme	Inspektori veterinarë (nëse angazhohet)
Takime konsultative me fermer,	Sipas nevojës	Inspektori veterinarë (nëse angazhohet)

Aktivitetet e lartcekura përfshijnë në parim aktivitetet e Drejtoratit në tersi që nuk kufizohen vetëm me to, kurse ky plan pune do të detajohet me planet operative mujore nga inspektorët e fushave përkatëse.

Inspektorët komunal punën e tyre e kryejnë varësisht prej fushës së veprimtarisë sipas Ligjeve dhe akteve tjera normative si vijon:

- LIGJI MBI TREGTINË E BRENDSHME, NR 2004/18,
- LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT, NR 204/17,
- LIGJI PËR INSPEKTORATIN E TREGUT, 03/L-118,
- LIGJI PËR NJËSITË MATËSE, 2004/11,
- LIGJI PËR METROLOGJI, 03/L-203,

-LIGJI PËR INSPEKTORATIN SANITAR, NR 2003/22,
-LIGJI PËR KONTROLLIN E DUHANIT, 04/L-156,
-LIGJI PËR VETERINARIN, 2004/21,
-LIGJI PËR KUJDESIN NDAJ KAFSHËVE , 02/L-10,
-LIGJI MBI NDËRTIMET, NR. 04/L-110
-LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT ME NR. 03/L-025 2009 10
GUSHT 2011
-LIGJI PËR MBROJTJEN E NATYRËS ME NR.03/L-233 2010 28 MAJ
2013
-LIGJI PËR MBETURINA ME NR. 04/L-060 2012 24 SHTATOR 2012
-LIGJ PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR ME NR. 03/L-230
2010 10 GUSHT 2011
- UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH-NR. 13 /2017 PËR
MENAXHIMIN E MBETURINAVE MEDICINALE-PATOLOGJIKE
-LIGJ PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS ME NR. 03/L-214
2010 10 GUSHT 2011
-LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË
NDOTJES ME NR. 03/L-043 2009 10 GUSHT 2011
-LIGJIN PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA ME NR. 02/L-102 2007 10
GUSHT 2011
-LIGJI PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA ME NR. 03/L-160
2010 25 SHKURT 2010,
-UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH-SË NR. 12 /2017 PËR
SHPALLJEN E LLOJEVE TË EGRA STRIKT TË MBROJTURA
-UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH - NR. 02/2017 PËR LISTËN E
KATEGORIVE TË MBETURINAVE TË RREZIKSHME SIPAS
ORIGINËS
-UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH - NR.27/2014 PËR
MENAXHIMIN E MBETURINAVE NGA AMBALAZHET DHE
PAKETIMET
-UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH – NR.24/2014 PËR
KLASIFIKIMIN E VLERAVE TË MBROJTURA TË NATYRES
SIPAS RËNDËSISË
-UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.06/2008 PËR ADMINISTRIMIN E
MBETURINAVE TE RREZIKSHME
-UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 2005/12 PËR PËRMBUSHJEN E
KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE PËR LOKALE AFARISTE,
-UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 09/2015 MJEDISI PA TYM
DUHANI DHE VENDOSJA E SHENJAVE PËR NDALIMIN E PIRJES
SË DUHANIT NË HAPËSIRA TË MBYLLURA,

-UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH 18/2013 PËR STANDARDET MINIMALE DHE PROCEDURAT PËR MBIKËQYRJE ADMINISTRATIVE DHE LËSHIMIN E CERTIFIKATËS SE PËRDORIMIT,
-RREGULLORJA KOMUNALE MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE MINIMALE HIGJENIKË-TEKNIKE PËR PUNË,
_RREGULLORJA KOMUNALE MBI LARTËSINË E TAKSAVE ,
NGARKESAVE DHE GJOBAVE PËR SHËRBIME KOMUNALE,
-RREGULLORJA KOMUNALE MBI ORARIN E PUNËS PËR LOKALET AFARISTE, OBJEKTET HOTELIERE DHE SHËRBIME TJERA NË KOMUNËN E DEÇANIT,
-RREGULLORJA PËR LEJE PUNE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AFARISTE,
-RREGULLORJA MBI NDALIMIN E EKSPOZIMIT TË MALLRAVE USHQIMORE JASHTË HAPËSIRAVE TË LOKALEVE AFARISTE,
-LIGJE TJERA DHE AKTE NËNLIGJORE SI DHE RREGULLORE KOMUNALE SI DHE VENDIME TË KRYETARIT TË KOMUNËS APO KUVENDIT KOMUNAL DHE KOMITETEVE TË TIJE TË APROVUARA NË NDËRKOHË .

Kërkesë për kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj;

Për mbarëvajtjen dhe kryerjen me sukses të punëve dhe detyrave të drejtoratit, kërkoj nga Kryetari i komunës të ndërmerr veprimet në vijim:

Plotësimi sa më shpejt që është e mundur i vendit të lirë të punës së inspektorit të ndërtimeve,
Angazhimi i një inspektori të Veterinës (qoftë edhe si shërbim të kontraktuar me autorizim),

Kërkojmë bashkëpunim me Drejtoratet tjera e posaçërisht me çështjet që kane të bëjnë me fushë veprimtarin e secilit nga inspektorët, e veçanërisht kërkojmë nga Drejtorati për Urbanizëm.... që me kohë ta njoftoj Inspektorin e Ndërtimit për çdo leje ndërtimore të lëshuar me qëllim të përcjelljes së punimeve.

Drejtori

Halil Tolaj

